REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KRUJE

LEJE NDERTIMI

TË SHTËPIVE INDIVIDUALE SIPAS PROJEKTEVE MODEL NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANË

Nr. 7963Prot. **Datë 20/11/2020**

VENDIM
Nr. 242, datë 20/11/2020

Mbështetur në nenet 7/2 dhe 44, shkronja "a" të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, nenet 37 dhe 38 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, nenet 9, 10 dhe 10/1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 44, datë 22.01.2020 "Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësi në Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese"; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe te procedures se pershpejtuar per hartimin dhe miratimin e planit te detyruar vendor, si dhe procedures se miratimit te lejeve", i ndryshuar, dhe në bazë të dokumenteve të planifikimit (PPV/PDyV Nj. A. Thumanë), pas shqyrtimit të kërkesës nr. Prot. 7940, datë 19/11/2020, për *"Leje rindertimi, rikonstruksioni dhe riparimi të nderteses së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore me shtim apo ndryshim volumi"* për në pasuritë që ndodhen brenda zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Thumanë, ZK 2182 & 3599, me adresë Thumanë, Krujë, dhe dokumentacionit shoqërues të kërkesës;

Gjithashtu bazuar në:

- Marrjen zyrtarisht të mendimeve/pëlqimeve nga institucionet publike të parashikuara nga ligji, si vijon:
    - *ASHK Krujë*
    - *OSHEE Durrës*
    - *PMNZSH Krujë*
    - *Ujësjellës Kanalizime Krujë*

- Raportin e Vlerësimit Teknik pozitiv nr. 7962 prot. datë 20.11.2020 nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;

VENDOSA:

1. Lëshimin e kësaj lejeje ndërtimi të shtëpive individuale sipas projekteve model në zonat e reja për zhvillim për zhvilluesin Fondacioni "FIRDEUS" & Fondi Shqiptar i Zhvillimit & Bashkia KRUJË, të cilit i lejohet ndërtimi i objektit/ve **"Projekte model për rindërtimin e shtëpive individuale, me kosto të ulët dhe efiçensë energjie" në zonën e re për zhvillim në njësinë administrative Thumanë"** për në pasuritë që ndodhen brenda zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Thumanë, ZK 2182 & 3599, me adresë Thumanë, Krujë sipas kushteve të zhvillimit që vijojnë:

KUSHTET E ZHVILLIMIT:

Njësia vendore : BASHKIA KRUJË

Emërtimi i punimeve: **"PROJEKTE MODEL PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE, ME KOSTO TË ULËT DHE EFIÇENSË ENERGJIE" NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË ADMINSTRATIVE THUMANË".**

Lloji i punimeve: Punime të ndërtimit të shtëpive individuale sipas projekteve model të EKB-së.

Zhvilluesi: FONDACIONI "FIRDEUS" & FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT & Bashkia KRUJË

Kodi i njësisë strukturore: **Sipas Planit të Detyruar Vendor (PDyV) të hartuar për zonën e re për zhvillim në njësinë administrative Thumanë shpallur me VKM nr. 44 datë 22.01.2020.**

Kushtet e lejes janë sipas të dhënave të projekteve model të hartuara nga Enti Kombëtar i Banesave dhe planvendosjes Sipas Planit të Detyruar Vendor (PDyV) të hartuar për zonën e re për zhvillim në njësinë administrative Thumanë shpallur me VKM nr. 44 datë 22.01.2020.

2. Lëshimin e leje prishje për objektet që preken nga projekti në përputhje me VKM e shpronësimeve për zonën e re për zhvillim në njësinë administrative Thumanë.

3. Afati kohor i kësaj leje është **12 muaj** nga data e fillimit të punimeve, referuar afatit të punimeve të kontratës.

4. Pas përfundimit të punimeve të kthehet territori në gjendjen e mëparshme të riparohen të gjitha dëmet në rrugë etj.

5. Për cdo ndërhyrje për lidhje me rrjetin e infrastruktures publike sipas projektit të miratuar nga ndërmarrja përkatëse e infrastrukturës të jetë i pranishëm specialisti i zonës ose përfaqësues i ndërmarrjes përkatëse (të merren miratimet përkatëse) për të mos krijuar shqetësime në rrjetin publik.

5. Të mos bëhen ndryshime nga projekti i miratuar, pa miratimin paraprak nga Bashkia Krujë apo Njësia Zbatuese, sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

6. Në rast shkelje të kushteve të kësaj leje do të merren masa në përputhje me ligjin, deri në prishje të punimeve të kryera. Zhvilluesi, zbatuesi dhe mbikqyrësi i punimeve janë përgjegjës solidarisht në rast kryerje punimesh në shkelje

të kësaj lejeje apo të ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

7. Një kopje e vendimit i dërgohet zyrtarisht I.V.M.T pranë Bashkisë Krujë nëpërmjet sistemit e-lejet për ndekjen e procedurave të inspektimit.

8. Të respektohen normat dhe standardet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi kryerjen e punimeve dhe sigurinë në punë.

9. Gjatë zbatimit të punimeve objekti do të kontrollohet nga autoritetet e kontrollit të zhvillimit dhe inspektorati përkatës në fushën e ndërtimit.

10. Zhvilluesi është i detyruar që të njoftojë paraprakisht bashkinë dhe IVMT për fillimin e punimeve si dhe të komunikojë emrin e mbikqyrësit, së bashku me licensat profesionale përkatëse. Në mungesë, punimet konsiderohen të paligjshme

11. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

ARTUR BUSHI

Artur Bushi

Digitally signed by Artur Bushi
Date: 2020.11.20 16:07:36 +01'00'